

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 15 MAJ 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 15. 05. 2003. GOD.

MAJ - 2003



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme
2. Shqyrtimi i rezolutës për njohjen e Luftës Çlirimtare të Popullit të Kosovës për Liri dhe Pavarësi
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kooperativat bujqësore
4. Shqyrtimi i rekomandimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës për emrimin e gjyqëtarëve
5. Parashtrimi i pyetjeve
6. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 22 Maj 2003
 - 6.1 Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për plehrat-2003/8
 - 6.2 Shqyrtimi i parë i P/ligjit për qasje në dokumente zyrtare-2003/11
 - 6.3 Shqyrtimi i parë i P/ligjit për regjistrimin e popullatës, ekonomive familjare dhe të banesave

Vrejtje : Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë

“Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtrësia të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.
(Rregulla 21.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице
2. Разматрање Резолуције о признавању ослободилачког рата народа Косова за слободу и независност
3. Друго разматрање Нацрта закона о пољопривредним задругама
4. Разматрање препоруке Судског и Тужилачког Веча о именовању Судија
5. Постављање питања
6. Предлог дневног реда за пленарну седницу од 22 маја 2003
 - 6.1 Друго разматрање Нацрта закона о вештачким ђубривима-2003/8
 - 6.2 Прво разматрање Нацрта закона о приступу службеној документацији-2003/11
 - 6.3 Прво разматрање Нацрта закона о попису становништва, породичних економија и станова

Опомена : *Питања упучена Влади за усмене одговоре*

“Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се оћекује одговор”
(Правило 21.2 са Привремени пословник)



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting
2. Review on the Resolution to acknowledge the Liberation War of People for Freedom and Independence in Kosovo
3. Second reading of the Draft Law on the Agricultural Cooperatives
4. Review of the recommendation from the Judicial and Attorney ship Council of Kosovo concerned on the nomination of the Judges
5. Questions
6. Proposal of agenda for the plenary session of 15 May 2003
 - 6.1 Second reading of the Draft Law on the pesticides-2003/8
 - 6.2 First reading of the Draft Law on the accessing the official documents-2003/11
 - 6.3 First reading of the Draft Law on the registration of the population, family Properties and housing

Note: *Questions to the Government for oral answer*

“Questions for oral answer shall be submitted to the Table Office at least five working days but not more than ten working days before they are to be answered” (Rule 21.2 of Provisional rules of procedure)

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 15 MAJ 2003

**KRYESUES I SEANCËS, AKADEMIK NEXHAT DACI,
KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.**

**BASHKËKRYESUES, XHAVIT HALITI, ANËTAR I KRYESISË
SË KUVENDIT TË KOSOVËS.**

Seanca filloi punën në orën 10,00

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur në Seancën e rregullt plenare të Kuvendit të Kosovës.

I dëshiroj mirëseardhje ministrit të bujqësisë dhe të gjithë të tjerëve.

Materialet, lidhur me këtë Seancë dhe rendin e ditës, i keni marrë me kohë.

Prandaj, pa humbur kohë, propozoj që të fillojmë me miratimin e Procesverbalit nga seanca e kaluar.

Urdhëroni, zoti Luzha.

BERAT LUZHA:

Zotëri kryetar,

Në prak të mbledhjes së kalaur, vetëm pak minuta para se të fillonte mbledhja plenare e Parlamentit të Kosovës, ndodhi skandali i papritur politik, që ju, pa të drejtë, e quajtet incident teknik apo gjëja një mosmarrëveshje e vogël. Dhe në vend dhe vërtetë të kishit krijuar një unitet veprues, ashtu siç keni deklaruar, duke u

pozicionuar në anën e Partisë që i takoni, harruat se keni për detyrë ta mbroni secilin deputet pa dallim përkatësie partiake, u përpoqët ta relativizoni krimin politik para syve tanë dhe opinionit publik duke tentuar ta barazoni fajin e kriminelit me atë të viktimës.

Grupi Parlamentar i PDK, rithekson sulmin ndaj deputetit Gani Koci, që ishte akt kriminal, jospontan, por i paramenduar, i parapërgatitur dhe në kontinuitet. Gjithashtu shprehim shqetësimin tonë ndaj papërgjegjësisë së organeve gjegjëse të sigurisë së UNMIK-ut të cilat nuk ndërprejnë por lejojnë veprime të këtij grupi, pjesë e të cilit është edhe sulmuesi. Policia e UNMIK-ut e di fare mirë se deputeti Fadil Geci dhe grupi i tij, që nga viti 98, është implikuar në dhjetëra raste të vrasjeve, tentimvrasjeve, rrahjeve dhe kërcnimeve ndaj qytetarëve.

Grupi Parlamentar i PDK, shprehë shqetësimin pse kreu i LDK nuk distancohet nga implikimi dhe instrumentalizimi i krimit në politikë, të cilin e vlerësojmë si prapësi morale, kombëtare, politike dhe intelektuale.

Ne nuk jemi këtu në gjykatë dhe ju nuk jeni gjykatës, zoti kryetar, të gjykoni se çfarë duhet të hyjë në procesverbal dhe çfarë nuk duhet, se çfarë ishte deklarata. Të ritheksojmë se deklarata ishte parlamentare, ishte e përpiluar në Parlament dhe ishte e një pjese të konsiderueshme të deputetëve, të një Grupi Parlamentar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike kërkon edhe një herë që ajo deklaratë të kthehet në procesverbal si një dokument valid i këtij Kuvendi. Ftohen edhe një herë të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallime partiake, për mosimplikime dhe distancime të thella nga dukuri, formacione politike e individ të tillë.

Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti Luzha, ju falemnderit edhe për aktakuzë! Qëndroj në atë që kam thënë në mbledhjen e kaluar.

Po vazhdojmë me rendin e ditës, të cilin rend e kemi mjaft të rëndësishëm. Nëse paraqitesh për procesverbal, mund ta merrni fjalën dhe urdhëro...

ISMAJL KURTESI:

Zoti kryetar, tash po i drejtohem edhe sekretarit.

Dëshiroj vetëm t'ju informoj se në Rregullën 20, ku flitet për publikimin dhe regjistrimin e seancave plenare, ndër të tjera thuhet: "Çdo seancë e Kuvendit regjistrohet me inçizim elektronik. E gjithë puna e Kuvendit nxirret si transkript.". Transkripti i fundit është falsifikuar, meqë në të s'ka dalë krejt ajo që është thënë, prandaj kërkohet që kjo të plotësohet, do të thotë transkripti të plotësohet me krejt atë që është thënë në mbledhjen e fundit. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Unë i kam sqaruar Kryesisë çka mund dhe çka nuk mund të lejohet të futet në dokumentacione të Parlamentit dhe i kam thënë që përgjegjësinë politike e marr mbi veti. Duhet t'i lexoni edhe nenet tjera, zoti Kurteshi! Prandaj, ju lutem çdo gjë është konform Kornizës kushtetuese dhe Rregullores në fuqi të Parlamentit. Edhe këtë vërejtje do ta shqyrtojmë.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Ata që kanë vërejtje në Procesverbal le të urdhërojnë ta marrin fjalën. Nuk është në rend të ditës miratimi i Transkriptit, por i Procesverbalit. Dhe, ata që kanë vërejtje në të, le t'i bëjnë me shkrim, e pastaj do t'i shqyrtojmë.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës: - **Shqyrtimi i Rezolutës për luftën çlirimtare të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi.**

Mendoj se shefat e grupeve parlamentare mund ta shfrytëzojnë mundësinë, nëse dëshirojnë ta thonë mendimin e grupeve të veta parlamentare dhe pastaj të vazhdojmë. Të shkojmë sipas madhësisë së grupeve parlamentare. Zoti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI:

Zotëri kryetar i Kuvendit, deputetë të çmuar dhe të nderuar kolegë,

Sot kemi në rend të ditës një dokument, i cili do të jetë prodhuar nga kërkesat e arsyeshme të zgjedhësve tanë dhe nga logjika sociale e politike, e unë do të thosha edhe morale dhe obligimeve që ka ky Parlament para zhvillimeve politike e shoqërore në Kosovë për disa vite prapa e disa decenie.

Ne sot këtu, me këtë dokument, dëshirojmë të japim mendimin për ato vlera, të cilat njerëzit e këtij vendi i kanë dhënë për vite e vite me qëllim të njëjtë dhe të vetmin: që të jetojnë të lirë; të jetojnë të pavarur; të vendosin për mënyrën e jetesës së vet dhe të vendosin për të ardhmen e vet.

Në këto vite, ne kemi tipat e ndryshme të veprimtarëve, qysh janë të ndryshme edhe biografitë dhe situatat sociale e politike dhe kohërat. Këta njerëz, këta veprimtarë që jetën e vet, dijen e vet, mundin e vet, djersën, dikush edhe pasurinë - i kanë dhënë për këtë qëllim, dikush në një kohëzgjatje më të madhe, dikush me një koncentrim dhe flijim të përnjëhershëm - të gjithë e kanë vlerën e vet të barabartë në pantionin e vlerave të njerëzve që punojnë për vendin dhe njerëzit e vet.

Duke pasur parasysh të gjitha këto elemente, duke pasur parasysh një të drejtë politike, unë do të thosha edhe morale, në rastin e tretë edhe sociale, që shtrohet sot para nesh dhe para zgjedhësve tanë, ne me përgjegjësi të jashtëzakonshme kemi biseduar rreth formulimeve të mundshme që t'i kemi bashkë të gjitha këto në një dokument të votuar në Kuvend. Dhe, kujtoj që, me arsyen politike dhe me arsyen shoqërore, kemi arritur të ndërtojmë një tekst i cili nderon veprimtarët që kanë dhënë gjithëmundin por edhe jetën për Kosovë të lirë e demokratike, nderon një organ përfaqësues, siç është Kuvendi ynë, po edhe të tjerët veç e veç.

Unë mendoj që ky është një moment i veçantë për Kuvendin e Kosovës dhe për të gjithë njerëzit në Kosovë që, duke vlerësuar punën e pararënësve tanë dhe bashkëkohanikëve tanë, në të vërtetë vlerësojmë punën tonë ose, shkurt - krijojmë rrugën kah ndërtimi i një shoqërie demokratike e të pavarur, e cila do të jetë e barabartë për të gjithë qytetarët e saj.

Dhe, unë mendoj që jemi të njëmendjeje dhe nuk kemi pse mos ta ngrisim dorën për një program të tillë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Arsim Bajrami, shef i Grupit Parlamentar të Partisë së dytë në Parlament.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuar kryetar, të nderuar kolegë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, jap mbështetje të fuqishme miratimit të kësaj rezolute dhe konsideroj se miratimi i kësaj rezolute paraqet një akt historik, me të cilin konfirmohet një realitet historik në të cilin ka kaluar Kosova.

Mendoj se, duke miratuar sot këtë rezolutë, ne përmbushim një obligim që kemi ndaj popullit të Kosovës, i cili ka kërkuar njohjen e kontributit të vet në çlirimin e Kosovës dhe në afrimin e saj drejt shtigjeve evropiane.

Mendoj se përmes kësaj rezolute ne po legjitimojmë luftën çlirimtare, të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe po legjitimojmë tërë përpjekjen politike për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Në fakt ne me këtë, po konstatojmë një realitet historik në të cilin ka kaluar Kosova dhe po ua ofrojmë të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare opcinin tonë për partneritet në ndërtimin e një të ardhme të përbashkët për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Mendoj se miratimi i kësaj rezolute dhe sigurimi i një koncencusi nga partitë kryesore politike dhe nga qytetarët e Kosovës, është një shancë e mirë për të krijuar një unitet midis faktorit politik shqiptar e joshqiptar dhe për të trasuar një rrugë të përbashkët për një të ardhme të përbashkët për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Miratimi i kësaj rezolute, me asgjë nuk konteston rregullativën ligjore ndërkombëtare në fuqi në Kosovë. Përkundrazi, mendoj se është në frymën e dokumenteve më të avancuara ndërkombëtare që përcaktojnë standardet për liri dhe për të drejtat e njeriut. Është në frymën edhe të Kartës së Kombeve të Bashkuara, e cila, të gjithë popujve, ua njeh të drejtën për vetëvendosje.

Ne, si Grup Parlamentar, kërkojmë nga Qeveria e Kosovës - si organ ekzekutiv i Kuvendit, që pas miratimit të kësaj rezolute, të përgatisë në kohën sa më të shpejtë tërë kuadrin ligjor me të cilin realizohet kjo rezolutë dhe njëkohësisht të ofrohen garancione materiale dhe satisfaksione tjera për të gjithë pjesëmarrësit e luftës çlirimtare, në mënyrë që Kuvendi i Kosovës, vërtetë t'i dalë borxhit të gjithë atyre që ranë për Kosovën, të gjithë atyre që luftuan për ditën e sotit, të gjithë atyre që mundësuan që Kosova sot të jetë e lirë dhe t'iu ofrojë mundësi të gjithë qytetarëve të saj që së bashku të projektojnë dhe të ndërtojnë një të ardhme të përbashkët. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Dragisha Kërstoviq, Grupi i tretë parlamentar përnga numëri i ulësve në Parlament.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, dame i gospodo poslanici,

Srpska koalicija «Povratak» se danas ponovo nalazi u velikoj neprilici i veoma neprijatnoj situaciji. Bili smo uvereni da su euforije i političke promocije prošlost i da će ovaj Parlamnt početi da se posvećuje onim pitanjima i problemima koji će biti od značaja za poboljšanje života na ovim prostorima i da će otpočeti proces pomirenja i zbljižavanja nacionalnih zajednica koje na ovom prostoru žive.

Ponovo smo, dakle, pred dilemom: izaći ili ostati. Da li je moguće da Kosovo bude multietničko ili ne; da li Srbi na Kosovu imaju budućnost i perspektivu i nije li ovo, što radimo i za šta se borimo, velika zabluda i definitivna iluzija?

Srbi i njihovi predstavnici u privremenim institucijama samouprave neće pristati na ovakve vrste neistina i oni će pokušati da iz svoje istorijske prošlosti nauče lekciju za stvaranje bolje i lepše budućnosti za sve koji žive na Kosovu. Mi ne želimo da živimo u prošlosti. Mi ne želimo da veličamo one naše koji to ne zaslužuju ali ne želimo ni da drugi veličaju svoje kojima zasigurno istorija neće obezbediti zavidno mesto. I konačno, ne možemo da prihvatimo da za oslobodioce mogu proglasiti oni o čijoj oslobodilačkoj borbi, pod znacima navoda, Srpski narod teško postradao; ne možemo a da u ovom Parlamentu žestoko ne odreagujemo i da prihvatimo da je neko oslobodilac a da su Srbi za sve to vreme ubijani, da su prognani u ogromnom broju i sa većeg dela Kosova i metohije, da su im kuće spaljene i porušene mnogobrojne svetinje i da ni posle četiri godine nisu u prilici ca se vrate u svoje domove i na svoja ognjišta, ni u prisustvu međunarodne mirovne misije i memdjunarodnih bezbednosnih snaga.

Rezolucija, koja će danas, voljom parlamentarne većine, biti usvojena će zasigurno biti nešto što će Albansku i Srpsku zajednicu zadržati tamo gde još uvek jesu – udaljenu jedno od druge, bez ikakve mogućnosti za dijalog i približavanje sa potpunom neizvešnošću za pomirenje i multietničku saradnju i bez šansi barem za neko duže vreme za bilo kakvu integraciju Srba u kosovsko društvo.

Rezolucija će istovremeno značiti otvorenu poruku raseljenim Srbima da je njihov povratak na Kosovu i metohiji nepoželjan i da zajednički život nije moguć.

Rezolucija će usporiti i zaustaviti mnoge procese a kod Srba će zasigurno pojačati strah od povratka i neizvesnost od mogućeg ostanka i opstanka na Kosovu i metohiji.

Rezolucija će, na kraju, obesmisлити i neke korake, učinjene ovih dana u pravcu otpočinjenja dijaloga između nekih albanskih političkih entiteta i Srpske koalicije «Povratak» i vratiće na početak ili možda i dalje sve ono što je do sada učinjeno.

Koalicija «Povratak» će se zalagati za mir; za povratak svih raseljenih; za bezbednost i slobodu kretanja svih; za poštovanje Rezolucije Saveta bezbednosti 1244. i Ustavnog okvira za samoupravu na Kosovu; za legalizam u ovom Parlamentu. Koalicija «Povratak» će izricati osude za sva kršenja ljudskih prava i prava nacionalnih zajednica i osuđivaće sve terorističke akcije sa bilo koje strane da dolaze.

Šta u kontekstu ove rezolucije znači rezolucija o pravu pojedinaca o povratku u svoje domove koji je ovaj Parlament usvojio 4. jula 2002. godine? Ništa, ili, i nešto više od toga! Rezolucija od 4. jula 2002. godine predstavlja farsu i bacanje prašine u oči svima onima koji se za povratak raseljenih istinski zalažu.

I ovo, što se danas hoće, je farsa i neistina. Nadamo se da će i oni koji rade na stabilizaciji ovog prostora prepoznati, u svemu ovome, sve ono što će imati kontraefekat na njihove napore da se ovaj prostor dovede u red i da se integriše u savremenu i demokratsku Evropu.

I, na kraju, rezolucija, koja se danas razmatra, će zasigurno dodatno opteretiti odnose između Albanske i Srpske nacionalne zajednice i zaustaviti procese koji su započeti u pravcu otvaranja dijaloga između predstavnika ove dve zajednice i njihovom približavanju.

Srpska Parlamentarna grupa koalicija «Povratak» smatra da je stavljanje ove rezolucije u Skupštinsku proceduru zloupotreba Skupštine, kao privremene institucije samouprave. Očekujemo da će SPGS adekvatno reagovati na eventualno usvajanje ove rezolucije ali će, bez obzira na to, i na konačnu sudbinu rezolucije, sve ovo imati veoma negativne posledice po brojne korake koji su uz velike napore učinjeni na ovom prostoru i da će ovo biti veliki korak unazad. Hvala!

Ja moram da vas obavestim da Srpska koalicija «Povratak» neće nastaviti rad po ovoj tački dnevnog reda!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ndoshta para se të largoheni, por kot është, sepse i keni hequr dëgjueset, desha me ju thënë. Po si ta vazhdoj kur ju jeni nisur ta lëshoni seancën. Desha t'ju them diçka por nuk po ma mundësojnë deputetët e Koalicionit «Kthimi».

Desha, pra, vetëm disa informacione Parlamentit në tërësi. Koalicioni «Kthimi» një kohë të gjatë në Parlament është shumë kontribues, ndihmon në zgjidhjen e problemeve.

Një pjesë e madhe e fjalës që e tha shefi i Grupit Parlamentar - është krejtësisht, krejtësisht dhe dokumentativisht e pavërtetë, sepse në 2-3 muaj që kemi bërë punë shumë konstruktive në Kryesi të Parlamentit, është kërkuar që pikërisht të harmonizohen të gjitha tekstet e mundshme, të gjitha idetë e mundshme parlamentare dhe teksti përfundimtar nuk i adresohet asnjë grupi etnik, asnjë grupi politik, asnjë grupi fetar, nuk e fajëson asnjë popull, nuk e fajëson asnjë shtet, prandaj shumëçka prej qëndrimeve të Koalicionit «Kthimi» janë qëndrime të këtij Parlamenti për kthimin e të gjithë të të shpërngulurve në pronën dhe pasurinë e vet, për jetën e sigurt. Ky parlament, në mënyrë unanime, ka votuar dhe vepron në atë drejtim që qytetarët e Kosovës të jenë të lirë, të sigurtë, të kenë qarkullim të lirë në tërë territorin e Kosovës dhe kemi punaur 3-4 muaj të fundit bashkërisht të gjitha grupet parlamentare.

Unë ftoj Grupin Parlamentar «Kthimi» që ta vazhdojë një punë që ka filluar kontribuese në Parlament dhe se ne do të jemi gjithmonë si Parlament për zgjidhjen e të gjitha problemeve, të secilës etni në veçanti, dhe të gjithë popullit të Kosovës në tërësi.

Prandaj, ato pjesë të pavërteta, konsideroj se nuk duhet të jenë pjesë e një dokumenti. Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Faik Marolli.

FAIK MAROLLI:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Grupi i të tjerëve - joserb dhe joshqiptar, në konsultim me, përveç grupit jo «Vatan», që nuk kanë ardhur ende s'kemi mund me u konsultue, përkrahë këtë ide dhe se vlerat e njohjes së luftës çlirimtare të popullit të Kosovës për liri e pavarësi si vlera që i kanë dhe si kredibilitet që kanë pasur deri sot dhe që kanë, na i njohim dhe përkrahim. Ndërsa, ata, kur të vijmë, ai grup «Vatan», e kemi vetën zonjën, ka thënë në përgjithësi ata do të shfaqin, do të japin vetë ndamas. Falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, zoti Marolli. Fjalën e ka zoti Dugolli. Kërkoj falje sepse përnga madhësia janë përafërsisht njënumërsh dhe besoj se s'është ofenduar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

BUJAR DUGOLLI:

Të nderuar deputetë, i nderuar kryetar,

Mendoj që sot, për Kuvendin e Kosovës, është një ditë shumë e rëndësishme dhe mund të them, ndoshta më e rëndësishmja qënga puna e këtij Kuvendi. Pas miratimit të këtij dokumenti të koncensusit të cilin Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe të dy përfaqësuesve të Komunitetit egjiptian që përbëjnë dhe janë pjesë e këtij Grupi, e mbështesim fuqimisht.

Ne do të dëshironim që, pas miratimit nga ky Kuvend, të kaluarën tonë të lavdishme të mos e shfrytëzojë askush për pretëkst përçarjeje ndërpartiake dhe ndëretnike. Ajo është e kaluar e popullit dhe don rrespekt dhe mbështetje nga gjithë populli.

Unë do ta lexoj tekstin final që e kanë hartuar dhe përkrahur tre grupet parlamentare më të mëdha politike në Kosovë.

KUVENDI I KOSOVËS
Prishtinë, më 15 maj 2003

Duke konfirmuar fitoren në luftën çlirimtare, të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, të mbështetur nga NATO, e udhëhequr nga SHBA dhe aleatët e saj;

Duke konfirmuar vendosmërinë e qytetarëve të Kosovës për shtetin demokratik, të pavarur dhe sovran;

Duke konsideruar se vlerat e luftës çlirimtare janë vlera të të gjithë popullit të Kosovës dhe vlera të pranuarra nga faktori ndërkombëtar,

Kuvendi i Kosovës, duke shprehur vullnetin e qytetarëve miraton këtë:

R E Z O L U T Ë
PËR LUFTËN ÇLIRIMTARE TË POPULLIT TË KOSOVËS PËR LIRI
DHE PAVARËSI

1. Lufta e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi të Kosovës, në të gjitha fazat dhe format e zhvillimit të vet: - luftë politike, rrezistencë paqësore dhe luftë të armatosur, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ka qenë luftë e drejtë për lirinë e vendit dhe për shoqëri moderne e demokratike;
2. Rrezistenca paqësore dhe lufta politike e konstitucionale, e shprehur me Kushtetutë dhe Referendum, ka përcaktuar vullnetin e qytetarëve të Kosovës për pavarësi dhe demokraci;
3. Lufta e armatosur e qytetarëve të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ka qenë luftë e drejtë dhe e pastër për çlirimin e Kosovës, luftë kundër forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe;
4. Lufta e NATO-s, e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka qenë luftë kundër dhunës e gjenocidit të pushtetit serb në Kosovë, për shpëtimin dhe çlirimin e popullit të Kosovës;
5. Lufta politike dhe e armatosur për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës është në themele të politikave që Kosova të bëhet shoqëri moderne, e lirë dhe demokratike për të gjithë qytetarët pa dallim bindjeje politike, besimi, përkatësie etnike apo racore; dhe
6. Kuvendi i Kosovës udhëzon Qeverinë e Kosovës që, në një kohë sa më të shpejtë, të përgatisë ligjet me të cilat do të rregullohet statusi i luftëtarit për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Këtë Rezolutë e mbështesin:

GRUPI PARLAMENTAR I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS,
Sabri Hamiti (i nënshkruar);
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS,
Arsim Bajrami (i nënshkruar); dhe
GRUPI PARLAMENTAR I ALEANCËS PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS,
Bujar Dugolli (i nënshkruar)

Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti Dugolli, ju falemnderit. Do të duhej t'i shtohet në proçesverbal edhe: **Grupi Parlamentar i të gjitha bashkësive etnike joserbe.**

Ju ftoj që ta votojmë tekstin e lexuar të Rezolutës.

Kush është për? Të gjithë.

(Të qëndruar në këmbë – duartrokitje frenetike)

E dij që nuk është askush kundër, por më duhet t'ju pyes:

A ka kush kundër? Askush. Ju falemnderit.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

- | | |
|--|--------------------------------|
| - Për – Za – For..... | Shumica – Veçina – Majority... |
| - Kundër – Protiv – Against..... | 00 |
| - Abstenime – Uzdržanih – Abstained..... | 00 |
-

Tani kemi një pauzë tridhjetëminutëshe dhe pastaj do të vazhdojmë punën.

(Duartrokitje)

(Vijon pauza)

(Pas pauzës prej 30 minutash Seanca vazhdoi punën)

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Kolegë deputetë besoj se janë plotësuar të gjitha kriteret për të vazhduar punën e seancës.

Po procedojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kooperativat bujqësore.**

Projektligji është miratuar në parim më 17 prill 2003.

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë rekomanduar amendamentet në tekstin e Projektligjit.

Departamenti për mbështetje dhe procedurë ka bërë radhitjen e amendamenteve.

- Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për kooperativat bujqësore ka bazueshmërinë në Kornizën kushtetuese;
- Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka konstatuar se Projektligji për kooperativat bujqësore nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve;
- Komisioni për buxhet, konstaton se ky ligj nuk ka implikime buxhetore dhe financiare.

Çdo amendament i propozuar më poshtë, në mënyrë specifike, reflekton qëndrimin e komisioneve.

Të pranishëm kemi edhe ministrin e bujqësisë.

Prandaj, pa humbur kohë, fillojmë me amendamentet.

Amendamenti 1, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Vë në votim propozimin e amendamentit.

Kush është për, i lutem le ta ngrisë dorën. Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 4, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 7, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 9, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 10, Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 11, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 12, Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 13, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 14, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon kush? Një abstenim.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 15, Dy propozime të ndryshme:

- a) Komisioni për buxhet;
- b) Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kush është për variantin nën a)?

Urdhëroni, për sqarim.

HAKI SHATRI:

Ju falemnderit, zoti kryetar.

Unë dola këtu të kërkoj nga deputetët që në këtë rast të votojnë për amendamentin e Komisionit për interesa të minoriteteve, meqenëse varianti që është propozuar nga ky Komision përfshin edhe përmbajtjen e amendamentit të Komisionit për buxhet. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit.

Kush është për versionin nën b) – Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti me versionin nën b).

Amendamenti 16, Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 17, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 18, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 19, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti. Dhe i fundit,

Amendamenti 20, Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Para se ta vë në votim Ligjin në tërësi të amendamentuar, ta theksoj një konstatim të rëndësishëm.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm çka do të thotë bujqësia për ne dhe besoj se nga kjo Ministri do të presim edhe propozime tjera dhe iu dëshirojmë sukses.

Kush është për Ligjin në tërësi, të amendamentuar? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Konstatoj se Ligji është i aprovuar.

(Duartrokitje)

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For.....Të gjithë – Svi – All.....
- Kundër – Protiv – Against..... 00
- Abstenime – Uzdrzanih – Abstained..... 00

Kalojmë në pikën e katërtë të rendit të ditës: Shqyrtimi i rekomandimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës për emërimin e gjykatësve.

Rekomandimi i Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial i është adresuar Kuvendit të Kosovës përmes PSSP, më 18 prill 2003.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka shqyrtuar dhe Kuvendit i ka bërë rekomandimet më 7 maj 2003.

Materiali komplet iu është dorëzuar të gjithë deputetëve.

Lus udhëheqësin e atij Komisioni, në atë kohë, zotin Kolë Berisha që t'na informoj për qëndrimin e Komisionit.

KOLË BERISHA:

Ju falemnderit, zoti kryetar,

Komisioni për legjislaturë, çështje gjyqësore dhe kornizë kushtetuese, më 29. 04. 2003, shqyrtoi propozimin e Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor dhe listën e të gjithë kandidatëve që janë propozuar për organet e judikaturës.

Komisioni ka dhënë pëlqimin për të gjithë, përveç një kandidati, e ky është Feti Tunuzliu, në shënimet e të cilit thuhet: Në periudhën 89-99 ka punuar si nëpunës specialist. Kjo «specialist» te ne pak në organet e judikaturës është pak si provokuese, prandaj kemi kërkuar shënime plotësuese për të.

Këshilli Prokurorial dhe Gjyqësor, ka dhënë këtë sqarim: në vijim të letrës tuaj, të datës 30 prill 2003, ku ju kërkon informacione të mëtejshme lidhur me punësimin nga periudha 89-99 të zotit Tunuzliu, kandidat të rekomanduar për emërim në Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, si zëvendësprokuror publik në Prokurorinë Publike të Qarkut në Mitrovicë, në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/18, të 6 prillit 2001, unë, **thotë**, kam kënaqësinë t'ju njoftoj me sa vijon:

Sipas vendimit të zotit Enver Nimani, kryetar i Shtëpisë Ndëshkuese-Korrektuese në Smrekovnicë, të datës 25 tetor 1989, zoti Feti Tunuzliu, kishte qenë i punësuar në kohë të pacaktuar si udhëheqës i këshilltarit ekzekutiv administrativ për punë juridike dhe të përgjithshme në Shtëpinë Ndëshkuese-Korrektuese në Smrekovnicë. Duke filluar nga data 1 maj 97, në përputhje me vendimin e Jusuf Karakushit, drejtor i Shtëpisë Ndëshkuese-Korrektuese në Smrekovnicë, zotit Feti Tunuzliut i

ishin caktuar detyra të regjistrimit të personave të dënuar dhe personave të dënuar për kundërvajtje në shërbimin e detyrave të përgjithshme, **shërbim që për mua është i paqartë**, dhe muajt e tij të punës në këtë post ishin llogaritur me një periudhë të rritur prej 12 muaj në 16 muaj.

Do të dëshiroja që t'ju siguroj ju dhe gatishmërinë më të madhe të Këshillit për ta ndihmuar Kuvendin në detyrën e tij të rëndësishme të shqyrtimit të kandidatëve të rekomanduar për emërim gjyqësor dhe prokurorial.

Pra, është një përgjegje që prapë nuk sqarohet ajo çka kërkohet prej nesh.

Po citoj edhe një herë shënimet që kanë dhënë: «Për periudhën 89-99 ka punuar si nëpunës specialist për çështjet në lidhje me të burgosurit në Burgun e Smrekovnicës». Çfarë specialisti ka qenë, nuk e di. Po, po, 89-99. Ju jeni anëtar i Komisionit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit zoti Kolë për informacionet plotësuese dhe besoj të mjaftueshme.

I kemi dy mundësi, që të hapim debat, që është krejtësisht normale, ose ta përkrahim mendimin e Komisionit.

KOLË BERISHA:

Nëse Kuvendi, sheh të arsyeshme që ky të pranohet, Komisioni nuk e kundërshton atë. Ky është arsyetim që është dhënë Këshilli Prokurorial Gjyqësor. Po, Komisioni ka kërkuar sqarime plotësuese, por s'e kemi shqyrtuar më vonë kjo. Komisioni s'ka punuar më tutje. Kjo është përgjegja që kanë dhënë ata.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Hydajet Hyseni, si anëtar i Kryesisë, pastaj Ramadan Kelmendi ka kërkuar fjalën.

HYDAJET HYSENI:

Zoti kryetar, zonja e zotërinj deputetë,

Janë dëgjuar kohëve të fundit konstatime befasuese për kinse prirjen e këtij Kuvendi për t'u konfrontuar me UNMIK-un! Këto kohë të fundit, ky Kuvend, ka dëshmuar, në disa raste pikërisht një prirje të kundërt për të manifestuar një bindje të çuditshme dhe jo dinjetoze pikërisht ndaj disa segmenteve të UNMIK-ut. Ditë më parë, ky Kuvend ishte fakultativ, ose, më falni, konsultativ. Aprovonte kode a procedurë të rregullt, amendamentonte ligjet me një propozim të një komisioni pa vendim të këtij Kuvendi, sepse kështu kishte kërkuar dikush në zyret e UNMIK-ut.

Sot, po shqyrtojmë rekomandimet, pa përcaktuar qartë çka do të bëjmë. Dhe kemi këtu dy lloj shkeljesh ose të them dy grupe të rënda shkeljesh. Një – procedurale, dhe tjerat – parimore. Dhe, është kjo diçka de zha vy për ne. Na ka ndodhur edhe muaj më parë. Kemi pasë bërë çështje, janë bërë rekomandime edhe nga Komisioni edhe nga ky Kuvend dhe në vend se të përmirësohet diçka, përkundrazi, procedura është keqësuar edhe më shumë. Deputetët bënin vërejtje edhe nga vendi – se nuk i kanë marrë dokumentat me kohë. Unë, si anëtar i Kryesisë, i kam marrë pardje pasdite. Dhe, për dy ditë, ju merrni me mend, a ka mundësi deputeti ose Kuvendi të shqyrtojë dhe të grumbullojë dokumentacionin për një çështje aq të ndieshme dhe aq të madhe.

Dhe kjo, mendoj, hapë një çështje shumë të rëndësishme dhe parimore. Nëse më lejoni, besoj se shumica prej jush, ka parë këtë skemë që e ka shpërndarë Zyra e UNMIK-ut për strukturën e institucioneve në Kosovë. Do të mund edhe kamera ta fokusonte vëmendjen te kjo! Dhe, pikërisht, sistemi juridik – gjyqësori, është ndarë në atë mënyrë sa edhe fizikisht edhe grafikisht nuk ka asnjë lidhje me institucionet e Kosovës. Është dëgjuar edhe këtu ndonjëherë se kjo është kompetencë e rezervuar dhe kjo e rezervuar është interpretuar pastaj si përjashtim i plotë i institucioneve të Kosovës.

Zonja dhe zotërinj, është në kundërshtim flagrant me Kornizën kushtetuese, me të cilën ne veprojmë. Dhe, është, për më tepër, tendencë e interpretimit restriktiv edhe në përputhje me të kaluarën. Kosova ka pasë, siç e dini, një strukturë të plotë ekzekutive në të gjitha fushat, edhe në fushën e jurisprudencës; ka pasur edhe në kohën e autonomisë së kufizuar; ka pasë edhe më vonë me qeverinë e përkohshme;

(Vërejtje nga kryeseusi: Ju lutem bisedat telefonike në sallë plenare nuk janë të lejueshme. Shkyçëni telefonatj!)

ka pasë madje edhe me strukturat e përbashkëta administrative një departament të posaçëm dhe tani nuk ka asgjë prej kësaj. Dhe, kjo, ndonjëherë, interpretohet si gjëja legale dhe unë e përsëris se është në kundërshtim të plotë edhe me këtë Kornizë e cila, edhe si e tillë, është restriktive dhe e gjymtë.

Siç e dini, ne edhe më parë kemi patur këtë çështje në shqyrtim dhe komisioni ka rekomanduar disa të propozuar dhe ka kontestuar disa të tjerë, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, me Kornizën kushtetuese, madje edhe me Rregulloren, me të cilën funksionon Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial. Por, ky Kuvend, kurrë nuk është informuar, dhe ato janë injoruar natyrisht dhe nuk janë marrë fare parasysh dhe atë me një arrogancë të pashpjegueshme, po ky Kuvend nuk është informuar kurrë - e ç'është ky Këshilli gjyqësor prokurorial, cila është gjendja në të, si funksionon ai. Ne kemi pasë vërejtje serioze, se nuk është i plotë, se është ndërtuar mbi baza të diskutueshme dhe për pasojë, praktikat që na imponohen prej saj janë vërtetë të papresedan.

Unë nuk dua të zgjas dhe të marr shumëkohë. Por, një praktikë e tillë e emërimit të gjykatësve, vërtetë nuk haset në asnjë vend. Do të dëshiroja që ekspertët e UNMIK-ut të na e gjejnë një vend të vetëm... Për pasojë, është një përzgjedhje negative për të cilën ne kemi diskutuar disaherë. Është një tendencë, nuk e dij prej kujt, që të favorizohen me çdokusht njerëzit që kanë qenë të implikuar në forma të ndryshme në taktikat e mëparshme që ne i kemi konsideruar se i kemi lënë gjithmonë pas.

Edhe me Kornizën kushtetuese, dhe s'dua të marr kohë që ta citoj, por edhe me dokumentet me të cilat vepron Këshilli gjyqësor, përjashtohen nga praktika ata që janë përfshirë në forma të ndryshme në procese diskriminuese dhe procese të montuara e tjera. Kurse, këtu, pikërisht të tillët na imponohen që disa herë edhe përkundër kundërshtimeve të argumentuara që i kemi pasur. Për shembull, janë dhënë argumente këtu, ta zëmë, se është emëruar si gjykatës a-prokurorë njerëzit që kanë procedurë të hapur, ju lutem. Kurse, përjashtohen, pa asnjë kriter njerëzit që kanë qenë viktimat të të njëjtave struktura, sepse të njëjtat struktura, shpesh, janë ata që vendosin dhe bëjnë ligje në këto çështje.

Unë po përmend vetëm një shembull. Një Zijadin Spahiu, që ka konkuruar qysh në rastin e parë për prokuror. Ka qenë i dënuar gjatë viteve 74... në një proces të kulluar politik, të monutar, pa asnjë faj. Për pasojë i është shkatërruar rinia, familja, janë bojkotuar e të gjitha ato. Më vonë, pastaj, ka arritur të përfundojë studimet, të fillojë të punojë dhe për shkak të valës së re të represionit është larguar përsëri nga puna e tjera. Në procesin, tash, të rizgjedhjes së gjykatësve dhe prokurorëve, ai është përjashtuar me arsye time qesharake, prej njerëzve që e kanë dënuar më parë e tjera.

Zonja e zotërinj, pyetja shtrohet – ku na çon kjo praktikë. Nuk kam qenë dhe nuk jam asnjëherë për qasje ekskluzive, as për pëjashtim të atyre që kanë qenë të përfshirë në një formë ose në tjetër në strukturat e sistemit të mëparshëm, por që ata të favorizohen ekskluzivisht dhe të pëjashtohen të tjerët, mendoj se ky nuk është vullnet i qytetarëve që ne përfaqësojmë, nuk është kërkesë e Kosovës së re dhe mendoj se nuk duhet ta lejojmë si praktikë.

Prandaj, unë kërkoj së pari mirëkuptimin tuaj, në përputhje edhe me Rregulloren tonë që kemi aprovuar, Rregulla 17 e së cilës e autorizon këtë Kuvend, siç e autorizon edhe Korniza, për të marrë vendim dhe jo vetëm për të shqyrtuar fakultativisht këtë çështje dhe në këtë kuadër për të bërë, siç thuhet në Rregulloren tonë, listën përfundimtare dhe për t'i kërkuar pika vijuese edhe nga Këshilli Gjyqësor Prokurorial informata plotësuese për kandidatët. «Ne kemi vepruar kështu, por nuk na kanë sjellë»...!? As tani, siç e keni parë, nuk ka të dhëna për ditëlindjen e tyre, nuk ka të dhëna a janë qytetarë të Kosovës ose jo, nuk kemi asnjë të dhënë kush ka konkuruar dhe kush janë refuzuar, kush janë ata që t'i krahasojmë dhe, sa jam i informuar, nuk janë informuar dhe nuk janë konsultuar madje fare as me asociacionet siç janë shoqata e gjykatësve, e prokurorëve, as vetë gjykatat në të cilat do të punojnë.

Praktika të tilla nuk nderojnë as praninë ndërkombëtare, as institucionin që ne përfaqësojmë.

Prandaj, unë propozoj që Kuvendi sot të mos e miratojë listën e propozuar, në përputhje edhe me procedurën tonë që kërkon që të kemi për dokumentet e shkruara një afat disaditësh në dispozicion, por të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor një informatë plotësuese në përputhje me ato që u thanë dhe vendimin ta marrim herën tjetër. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ramadan, nëse ke shkurt diçka, urdhëro.

RAMADAN KELMENDI:

I ndedruar kryetar, të nderuar deputetë,

Dola këtu të shpreh një shqetësim i cili bazohet në atë se ne kemi një akt, një dokument këtu që nuk përshkon me Rregulloren e punës, si dhe nuk mbështetet në Kornizën kushtetuese, një. Nuk mbështetet as në vullnetin e popullit shumicë në Kosovë. Fjala është për Mitrovicën dhe Kosovska Mitrovica. Nuk është

respektuar parimi i gjuhës dhe se Mitrovica është emërtuar dhe është diskutuar këto ditë në Asamblenë Komunale me emrin vetëm të vërtetë: Mitrovicë. Më duket se është e tepërt të elaboroj më tepër kur dihet se edhe dokumentet ndërombëtare e kanë pranuar Mitrovicën vetëm si komunë Mitrovicë dhe jo Mitrovica e Kosovës – Kosovska Mitrovica e tjera.

E dyta, mendoj se Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë duhet t'na njoftojë me kompetencat dhe autorizimet si dhe me propozimet për emërimë sepse unë në këtë drejtim më nuk dua të flas, kam diskutuar për kandidatët dhe nuk janë marrë në shqyrtim, andaj besoj se për secilin kandidat duhet të kemi të dhënat dhe ky Këshill të njoftojë Kuvendin e Kosovës me kompetencat e tij sepse autorizimet janë të tejkaluara rreth emërimeve, ne njohim kolegët tanë që punojnë nëpër gjykata dhe sistemin gjyqësor, historinë e tyre paraprake dhe të tanishme. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë.

Unë do të doja ta theksoj në konstatim. Kryesia e Kuvendit, ka vendosur në rend të ditës me propozim të Komisionit funksional. Komisioni ka kryer punën e vet sipas ndërgjegjes dhe profesionalizmit. Në Komision janë të gjitha grupacionet politike dhe etnike. Prandaj, bazuar në traditën që kemi në Parlament se mbështesim komisionet tona, sepse i kemi zgjedhur vetë...

Prandaj, kush është për propozimin e Komisionit, ju lutem le ta çojë dorën. Ju falemnderit.

Kush është kundër? Le të numërohen votat, ju lutem. 11 kundër.

A ka votë abstenimi? 16 abstenime.

Më lejoni të konstatoj se vendimi i Komisionit u aprovua me 11 vota kundër dhe 16 abstenime. Ju falemnderit.

Në fazën e parë të punës kemi qenë 78, tani janë edhe më tepër.

Pika e pestë e rendit të ditës është: Parashtrimi i pyetjeve.

Parashtrim të pyetjeve nuk ka patur.

Dhe, pika e fundit e rendit të ditës është – Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare më 22 maj 2003, si vijon:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plehërat;
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për qasje në dokumente zyrtare; dhe
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e popullatës, ekonomive familjare dhe banesave.

Mendoj se miratohet rendi i propozuar i ditës.

Mirëupafshim në seancën e ardhshme. Ju falemnderit.

Puna e seancës përfundoi në orën 12,30.

rt-1/26